

DORACAK

MBI DISPOZITAT LIGJORE QË MUNDËSOJNË USHTRIMIN E PROFESIONIT TË MJEKUT NË ZVICËR PËR SHTETASIT E VENDEVE JASHTË BE/EFTA¹

Ky doracak ka për qëllim t'iu ndihmojë para së gjithash mjekëve nga vendet tona të origjinës, të cilët janë të interesuar të punojnë në institucionet mjekësore zvicerane.

Këtu do të njiheni sadopak me mundësinë e ushtrimit profesional mjekësor brenda kornizave ligjore të konfederatës zvicerane.

1. MedBG - Ligji për Profesionet Mjekësore

Ligji për Profesionet Mjekësore (MedBG) i cili hyri në fuqi më 1 shtator 2007, përbën bazën ligjore për shkollimin, trajnimin e mëtutjeshëm si dhe praktikimin profesional të pesë profesioneve mjekësore universitare; mjekësisë humane, stomatologjisë, mjekësisë veterinare, farmacisë dhe kiropraktikës.

MedBG ka për qëllim të sigurojë lëvizjen e lirë të profesionistëve shëndetësorë me diplomë universitare në gjithë hapësirën e Konfederatës zvicerane.

Ky Ligj përfshin:

- Kërkesat që duhet të plotësojë arsimi universitar dhe aftësimi profesional.
- Parakushtet për marrjen e një diplome federale si dhe një titulli federal të arsimit të mëtutjeshëm (specializimit).
- Kërkesat për njohjen e diplomave të huaja dhe titujve të trajnimit të mëtutjeshëm.
- Kushtet për fillimin e një pune në Zvicër.
- Rregullat për "përgjegjësinë mbi biznesin privat".

1.1 Kriteriet për të punuar në Zvicër si mjek

Personave të profileve mjekësore që posedojnë një diplomë universitare në mjekësinë humane, stomatologji, mjekësinë veterinare, farmaci dhe kiropraktikë me origjinë nga vendet jashtë BE/ EFTA, gjegjësisht të cilëve nuk u njihet diploma në përputhje me Rregulloren e BE-së 2005/36, u kërkohet pikë së pari regjistrimi i diplomës në regjistrin mjekësor (MedReg), licenca kantonale për të ushtruar profesionin e tyre në Zvicër e poashtu njohja federale e diplomës.

¹ Informacione të nxjerrura nga Komisioni i Profesionit Mjekësor (MEBEKO) si dhe Zyra Federale të Shëndetit Publik BAG.

Në fakt, Zvicra njih diplomat e huaja dhe titujt e arsimimit të vazhdueshëm të profesioneve mjekësore të lëshuara nga shtetet kontraktuese, pra shtetet me të cilat ekziston një marrëveshje për njohjen e ndërsjellë të diplomave dhe titujve të arsimimit të vazhdueshëm. Një marrëveshje e tillë (marrëveshja për lëvizjen e lirë të personave) aktualisht ekziston vetëm me vendet e BE-së dhe EFTA-s.

1.2 Çka quajmë njohje direkte dhe indirekte të diplomës

Zvicra njih direkt diplomat në mjekësinë humane, stomatologji, mjekësi veterinare dhe farmaci nëse ato janë lëshuar në një shtet kontraktues. Kjo quhet *njohje automatike apo direkte*.

Nëse një shtet kontraktues, pra një vend tjetër nga BE/ EFTA njih një diplomë nga një vend i tretë (jashtë BE /EFTA), Zvicra atëherë pranon njohjen në mënyrë indirekte, por vetëm nëse aplikanti/-ja apo bashkëshorti /-ja e aplikantit është shtetas/e e EU -së. Kjo është ashtuquajtura ("*njohja e njohjes*"). Këtu është kusht edhe përvoja e punës të paktën tre vjet në pesë vitet e fundit para aplikimit, dhe poashtu duhet poseduar njohuri të mjaftueshme të një gjuhe zyrtare zvicerane (minimalisht nivelin B2).

Diplomat e marra jashtë BE/ EFTA pra nuk do të njihen nga Zvicra direkt pa i plotësuar kriteret e lartpërmendura. Aplikanti i cili nuk i plotëson kriteret e lartpërmendura megjithatë ka mundësi të pajiset me diplomë të njohur pasi t'a ketë dhënë provimin shtetëror (federal).

2. Regjistri i profesioneve mjekësore (MedReg)

Nga 1 janari 2018, nuk mund të ushtrohet aktiviteti profesional në Zvicër pa regjistrimin e diplomës në regjistrin e profesionit mjekësor, pra nga 01.01.2018 është DOMOSDOSHMËRI. Ky regjistrim para kësaj date nuk ishte domosdoshmëri përpos atyre që dëshironin të punonin në ordianca apo spitale private.

Ekzistojnë tri kategori që duhet regjistruar në MedReg:

1. Mjekët me titull mjekësor zviceran pranohen automatikisht në MedReg,
2. Mjekët me titull nga shtetet e BE-së, pranohen në MedReg, bazuar në marrëveshjen e lëvizjes së lirë si dhe njohjes së ndërsjellë.
3. Mjekët me titujt e fituar në vendet e treta që nuk mund t'iu njihet diploma direkt dhe tek të cilët MEBEKO rishikon kriteret që duhet përmbushur për t'u regjistruar (shih më poshtë nën 2.2.)

Nëse kategoria nën 3 plotëson kriteret e nevojshme, ata pranohen në regjistrin mjekësor. Nëse nuk plotësohen kushtet për regjistrim, MEBEKO përcakton kërkesat tjera të nevojshme për regjistrim.

Mjekët që ndodhen dhe punojnë tashmë në Zvicër para datës 1 janar 2018 dhe që nuk kanë qenë të regjistruar më parë, është dashur të regjistrohen të gjithë deri në fund të vitit 2019.

2.1 Verifikimi i gjuhës

Punëdhënësit janë të detyruar që tek mjekët të cilët ata i punësojnë të verifikojnë aftësitë e nevojshme gjuhësore për punën përkatëse (zakonisht gjermane, frënge ose italiane). Niveli B2 i Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencës për Gjuhët është kusht minimal.

2.2 Kushtet e domosdoshme për aplikimin në MedReg

Regjistrimi bëhet nëse përmbushen kërkesat e mëposhtme:

1. Nëse diploma e aplikantit lejon ushtrimin e profesionit në vendin e origjinës.
2. Nëse diploma e fituar në vendin e origjinës bazohet në trajnime që plotësojnë kërkesat minimale të mëposhtme:
 - për mjekët: periudhë shkollimi me kohë të plotë të paktën gjashtë vjet (studim me kohë të plotë ose 5500 orë mësim teorik dhe praktik ekuivalent me një universitet të njohur).
 - për stomatologët: periudhë shkollimi të paktën pesë vjet (studim me kohë të plotë ose 5000 orë mësim teorik dhe praktik ekuivalent me një universitet të njohur).
 - për kiropraktikantët: periudhë shkollimi të paktën gjashtë vite (studim me kohë të plotë ose 5500 orë mësim teorik dhe praktik ekuivalent me një universitet të njohur).
 - për farmacistët: periudhë shkollimi të paktën pesë vjet (studim me kohë të plotë ose 4500 orë mësim teorik dhe praktik ekuivalent me një universitet të njohur ekuivalent).
 - për veterinarët: periudhë shkollimi të paktën pesë vjet (studim me kohë të plotë ose 4500 orë mësim teorik dhe praktik ekuivalent me një universitet të njohur).

2.3 Aplikimi për regjistrim

Për regjistrim, duhet përdorur vetëm formularin e aplikacionit.

Formulari përmban të gjitha informacionet e nevojshme.

Kushtet tjera:

- Dokumentet duhet të dorëzohen me certifikim (vërtetim) origjinal. Dokumentet pa certifikim dhe dokumentet e certifikuara të kopjuara nuk pranohen.
- Certifikimi pranohet nga autoritetet zvicerane ose nga vendet e BE-së ose EFTA-s.
- Noterët, misionet diplomatike, administratat komunale, gjykatat, si dhe të gjitha autoritetet që lëshojnë dokumentet duhet të jenë të pranuar sipas rregullores së BE-së.

Nuk pranohen vërtetimet nga:

- Institucionet, vërtetimet e të cilave nuk mund të lexohen ose kontrollohen (përkthyesit, bamirësit, zyrat e famullive, sigurimet shëndetësore, bankat, spitalet, vetëcertifikime, etj).

2.4 Dokumentet e nevojshme për MedReg:

- Kopja e pasaportës ose kartës së identitetit me vërtetim origjinal.

- Nëse aplikanti nuk është shtetas i Zvicrës ose shtetas i një vendi të BE-së ose EFTA-s, nevojitet gjithashtu një kopje e pasaportës ose kartës së identitetit të bashkëshortit/es me vërtetim origjinal.
- Një kopje e certifikatës së martesës me vërtetim origjinal.
- Kopja e diplomës universitare me vërtetim origjinal.
- Kopja e një përkthimi zyrtar të diplomës në njërën nga gjuhët zyrtare gjermanisht, frëngjisht, italisht ose anglisht me vërtetim origjinal.
- CV (kurrikula jetësore).
- Letër motivimi me pikë referimi Zvicrën.
- Kopja e një konfirmimi me vërtetim origjinal që dëshmon se aplikanti mund t'a ushtrojë profesionin në vendin në të cilin është lëshuar diploma.
- Nëse konfirmimi nuk është në gjermanisht, frëngjisht, italisht ose anglisht, atëherë nevojitet një kopje e një përkthimi zyrtar të konfirmimit në origjinal në njërën prej këtyre gjuhëve. Ky konfirmim duhet të lëshohet nga autoriteti kompetent (p.sh. Ministria e Shëndetësisë) i shtetit ku është lëshuar diploma.
- Dëshmia e praktikës profesionale (Scope of practice).
- Kopja e një konfirmimi me vërtetim origjinal që diploma juaj e lëshuar jashtë vendit bazohet në trajnime që plotësojnë kërkesat minimale (shih kushtet e domosdoshme për aplikim).

Miratimet profesionale si psh "Aprobation" (Gjermani), "homologación" (Spanjë), "autorizimi d'exercice" (Francë) etj., nuk pranohen nëse konfirmimi juaj nuk është në gjermanisht, frëngjisht, italisht ose anglisht dhe nëse nuk ka vërtetim origjinal.

- Vërtetimi i aftësisë gjuhësore për njërën nga gjuhët zyrtare zvicerane (gjermanisht, frëngjisht, italisht).

Së bashku me kërkesën për regjistrimin e diplomës, aplikanti ka mundësinë të aplikojë për pranimin e njohurive gjuhësore për një ose më shumë nga tre gjuhët zyrtare zvicerane (gjermanisht, frëngjisht, italisht) për një tarifë shtesë prej 50,00 - 100,00 CHF.

Duhet poseduar një nga dokumentet e mëposhtme (origjinal ose kopje e vërtetuar) kur aplikohet për njohjen e gjuhës vendore;

- a. diplomë gjuhësore e njohur ndërkombëtarisht, të paktën niveli B2, sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët, jo më e vjetër se gjashtë vjet, ose
- b. një diplomë universitare në profesionin mjekësor të fituar në gjuhën përkatëse, ose
- c. Përvojë pune prej tre vjetësh në gjuhën përkatëse në profesionin mjekësor brenda dhjetë viteve të kaluara.

Dokumentet e kompletuara dhe formulari i plotësuar dërgohen në Zyrën Federale të Shëndetit Publik

MEBEKO
Schwarzenburgstrasse 157
CH - 3003 Bern

Tel: +41 58 462 94 83

- Dokumentet e dërguara nuk do të kthehen.
- Aplikantët që banojnë jashtë vendit duhet të shënojnë një adresë korrespondente në Zvicër.
- Tarifa për regjistrimin e një diplome të huaj në MedReg është midis 800 CHF dhe 1'200.
- Sapo të pranohet kërkesa për regjistrim, do të paguhet një paradhënie prej 390.00 CHF.
- Një fletë pagese me të gjitha informacionet e nevojshme të llogarisë do t'i dërgohet aplikantit me postë.
- MEBEKO, Departamenti i Trajnimit shqyrton vetëm aplikimet e plota dhe për të cilat është paguar paradhënia prej 390.00 CHF.
- MEBEKO, Departamenti i Trajnimit, ka të drejtën të kërkojë dokumente shtesë ose të kryejë ekzaminime shtesë sipas detyrës zyrtare në çdo kohë gjatë procedurës.
- Ata që kanë tashmë një diplomë të regjistruar në MedReg, mund të aplikojnë për punë në Zvicër.

3. Pranimi në punë

Aplikuesi mund të aplikojë drejtpërdrejt tek punëdhënësit e mundshëm, për shembull në spitalet shtetërore.

Në Zvicër, punëdhënësit janë përgjegjës për marrjen e lejes së punës për aplikuesit tek drejtoritë shëndetësore kantonale.

Shtetasve të vendeve të treta të cilave kantoni ua lëshon lejen e punës, fitojnë një leje qëndrimi afatshkurtër (letërnjoftim L).

Këshilli Federal vendos një numër maksimal të lejeve në vit. Pasi të arrihet numri maksimal i vendosur nga Këshilli Federal, lejet e qëndrimit afatshkurtër nuk mund të jepen më.

Pjesëmarrja në kurse të zgjedhura në universitet (regjistrimi si student mysafir ose vullnetar), pastaj hospitimet në klinika të ndryshme mund të ndihmojnë në rrjetëzimin sa më të mirë profesional dhe kështu në gjetjen e një vendi pune.

Kontakti me kolegët të cilët punojnë në Zvicër mund të ndihmojë poashtu për të mësuar për vendet e lira të punës.

Ata që punojnë në Zvicër por akoma nuk e kanë diplomën e njohur nga MEBEKO, mund të punojnë në institucionet shtetërore nën mbikëqyrjen e punëdhënësit, mund të kryejnë trajnime të mëtutjeshme në Zvicër, por nuk mund ta marrin një titull specializimi pa e kryer provimin federal.

Ndërsa kryerja e provimit specialistik mundëson ushtrimin e profesionit në mënyrë të pavarur (Neni 36, Paragrafi 2 MedBG).

Trajnimi i mëtutjeshëm (specializimi) organizohet dhe kryhet nga Instituti Zviceran për Edukimin dhe Trajnimin e Vazhdueshëm të Mjekësisë (SIWF), që është një institut autonom i FMH -së dhe i cili është përgjegjës për rregullimin dhe zbatimin e edukimit të vazhdueshëm mjekësor. SIWF jep tituj specialistikë përkatës në kuadër të programeve të akredituara të arsimimit të vazhdueshëm, gjithnjë nën mbikëqyrjen e Konfederatës e cila rregullisht kontrollon akreditimin si dhe cilësinë e këtyre kurseve.

Për secilin titull të arsimimit të vazhdueshëm ekziston një program i detajuar që përshkruan kohëzgjatjen dhe kërkesat për absolvimin e tij. Kohëzgjatja e trajnimit të mëtutjeshëm është 3 vjet për titullin minimal "mjek i përgjithshëm" dhe të paktën 5 ose 6 vjet për një titull specialist.

Trajnimi i mëtutjeshëm duhet të regjistrohet periodikisht në librin elektronik të SIWF | ISFM | siwf@fmh.ch |

Mjekët specialistë të cilët vijnë nga vendet e treta dhe të cilëve nuk iu njihet diploma universitare e marrë në vendet e treta, mund të kontaktojnë organizatat mbështetëse përgjegjëse për kurset përkatëse të arsimit të vazhdueshëm për të mundësuar eventualisht marrjen e një titulli federal të arsimit të vazhdueshëm:

- Mjekësia humane tek “Instituti Zviceran për Edukimin e Vazhdueshëm Mjekësor” (SIWF).
- Stomatologjia tek “Shoqata Zvicerane e Dhëmbëve” (SSO).
- Farmacia tek “Shoqata Zvicerane e Farmacistëve” (pharmaSuisse)
- Kiropraktika tek “Shoqëria Zvicerane e kiropraktikantëve” (ChiroSuisse).

Për modalitete më të detajuara, kontaktoni Komisionin e Profesionit Mjekësor (MEBEKO)

4. Kërkesat për njohje të diplomës nga vendet jashtë BE/ EFTA

Nëse një person posedon një diplomë të vendit të tretë (jashtë BE /EFTA), ai mund ta bëjë kërkesën për njohje të diplomës në Zvicër.

Në vendin e njohjes, siq u cek më lartë, aplikanti ka të drejtë të ushtrojë profesionin njëjtë sikur ata që kanë përfunduar shkollimin në vendin e njohjes sipas nenit 2, paragrafi 2 i Rregullores së BE-së 2005/36/EC.

Në vitet e fundit në disa kantone megjithatë është duke u rritur presioni për mjekët e vendeve të treta, që ata t’ a kryejnë provimin shtetëror, madje edhe nëse ata punojnë me kontratë pune të palimituar. Poashtu në shumë spitale si parakusht po kërkohet posedimi i një diplome të njohur.

Kështu që secili mjek që punon mbi tri vjet në Zvicër apo në shtetet kontraktuese prioritet ka pajisjen me diplomën federale mjekësore.

Një kërkesë përkatëse duhet t'i dërgohet Komisionit të Profesionit Mjekësor (MEBEKO), i cili specifikon kushtet për marrjen e diplomës.

4.1 Kushtet e aplikimit

- Aplikuesi duhet të ketë fituar një përvojë klinike në profesionin përkatës të paktën 3 vjet me pensum 100 % brenda 5 viteve të fundit. Informacioni i kërkuar:

1) fillimi dhe mbarimi i punës 2) funksioni dhe 3) shkalla e pensumit.

- Aplikuesi duhet të ketë njohuri të mjaftueshme për një gjuhë zyrtare zvicerane (të paktën nivelin B2). Niveli i njohurive gjuhësore duhet të dokumentohet tashmë edhe në regjistrin e profesionit mjekësor (MedReg).

Më gjërësisht sa i përket gjuhës është shënuar tek modalitetet e MedReg më lartë.

4.2. Lista e dokumenteve që duhet të dorëzohen

Dokumentat e mëposhtme duhet t'i bashkëngjiten formularit të aplikimit me personaliet i cili mund të shkarkohet nga faqja e BAG-së.

- CV (kurrikula jetësore)

- Kopja e pasaportës.

- Kopja e diplomës origjinale dhe përkthimi zyrtar.

- Lista e provimeve gjatë studimeve dhe përkthimi zyrtar.

- Nëse është e disponueshme, prova e përvojës profesionale jashtë vendit dhe përkthimi zyrtar përveç nëse origjinali është në gjermanisht, frëngjisht, italisht ose anglisht.

4.3. Regjistrimi për provimin federal

Kandidatët për provimet federale në mjekësinë humane, dentare, veterinare, farmaceutike dhe kiropraktikë mund të regjistrohen në provim përmes portalit online Online-Anmeldung.

Në webfaqen bag.admin.ch gjinden të gjitha informacionet për afatin e regjistrimit dhe fillimin e provimeve në disiplinat e ndryshme.

Këto mund të gjinden në skedën «datat e regjistrimit dhe provimit për provimet federale».

Regjistrimet me vonesë për fajin e kandidatit nuk merren në konsiderim, në këto raste regjistrimi është i mundur vetëm në vitin pasardhës.

Dokumentet që duhet të dërgohen si dhe i gjithë informacioni i rëndësishëm për plotësimin e regjistrimit në internet, mund të gjenden drejtpërdrejt në udhëzimet në regjistrimin online (në këtë faqe në skedën «lidhjet»).

Pranimi i regjistrimit tuaj online konfirmohet automatikisht.

Nëse kjo nuk funksionon, duhet kontrolluar dosjen SPAM të E-Mailit ose duhet kontaktuar zyren e komisionit mjekësor MEBEKO, gjegjësisht departamentin e trajnimit.

Gjatë regjistrimit, duhet cekur gjuhën varësisht vendndodhjes: (gjermanisht për Bazel, Bern dhe Cyrih; frëngjisht për Gjenevë dhe Lozanë).

Provimi federal në mjekësinë humane përbëhet nga dy pjesë:

1. Provimi interdisciplinar teorik (me shkrim) ang. multiple choice (MC).

Provimi MC është i ndarë në dy nën-provime dhe mbahet në fillimin e gushtit (nga ora 08-12:30 dhe përmban 2x 150 pyetje).

2. Provimi praktik është i njëtrajtshëm dhe i strukturuar njëjtë në mbarë vendin ashtu sikurse provimi teorik dhe quhet "aftësitë klinike" ose ang. clinical skills (CS). Kryhet sipas parimeve të një ekzaminimi klinik objektiv të strukturuar. Mbahet në fillimin e shtatorit.

Kandidatët që kanë përvojë pune mbi pesë vjet në Zvicër me pensum 100 %, i nënshtrohen vetëm provimit teorik, në të kundërtën ata që kanë më pak se pesë vjet (minimumi tre vjet në pesë vitet e fundit) duhet ti nënshtrohen provimit teorik dhe praktik.

- Testi vlerësohet zyrtarisht si i kaluar ose i dështuar, pra pa notë.
- Së pari kandidati informohet nëpërmes E-Mail, se a e ka kaluar provimin apo jo.
- Secili kandidat më pas do të pranojë me shkrim nëpërmes postës vlerësimin me numrin e pikëve të arritura.
- rezultatet e provimit priten më së largu në javën e tretë në tetor.
- që provimi të kalojë në tërësi, duhet kaluar në dy seksionet MC dhe CS.
- Nëse provimi dështon, provimi mund të përsëritet një vit më vonë.
- Ekzistojnë vetëm tre mundësi për të hyrë në provim.

Tarifat e provimit:

- Regjistrimi i provimit: 200 CHF
- Kostoja e provimit: 1500 CHF
- Diploma: 500 CHF

Përgaditi: Dr. Valbone Miftari, sekretare e përgjithshme e LMSHZ-së.

©Lidhja e Mjekëve